

UDHËZIM
Nr. 7, datë 7.10.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 2, DATË 11.2.2010 “MBI KONTROLLIN
TEKNIK TË MJETEVE RRUGORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 79 të ligjit nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 234 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZON:

1.Në nenin 1, pas pikës 6, shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7.Drejtuesit e mjeteve rrugore që kanë tahograf të instaluar në mjet, duhet të paraqesin te subjekti i licencuar për kryerjen e shërbimit të kontrollit teknik vjetor (KTV) certifikatën e kryerjes së operacionit teknik (inspektim/kalibrim) të tahografit, të lëshuar nga ofiçina e autorizuar. Në të kundërt ky shërbim nuk kryhet.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto